



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 308 Akti

Nr. 327 Vendimi
Tiranë, më 23.12.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 22.12.2020, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i 0 (zero), zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Valbona Vata**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Vata, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Valbona Vata është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Valbona Vata, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.3.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret: Xhensila Pine, Valbona Sanxhaktari dhe Etleda Çiftja
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe, më tej, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin, datë 18.3.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktoj kryesuese të trupit gjykues komisioneren Xhensila Pine. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Trupi gjykues, me vendimin, datë 10.12.2020, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Vata, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar bashkë me nenet D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
6. Në datën 11.12.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 18.12.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 18.12.2020, subjekti rivlerësimit, me anë të postës elektronike², dërgoi shpjegimet dhe provat e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.
8. Me vendimin e datës 18.12.2020, me anë të postës elektronike³, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Vata, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 22.12.2020, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

¹ E-mail datë 11.12.2020, ora 3:06 p.m. “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit”.

² E-mail datë 18.12.2020, ora 3:24 p.m. – “RE: Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit”.

³ E-mail datë 18.12.2020, ora 4:06 p.m. – “Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore”.

9. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Vata, bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Në datën 22.12.2020 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

13. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tri kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

14. Znj. Valbona Vata, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Vata, duke u bazuar mbi të tri kriteret e rivlerësimit.

16. Seanca dëgjimore e datës 22.12.2020 u ndërpre, për të rifilluar në datën 23.2.2020, për shpalljen e vendimit.

17. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 22.12.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

20. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organ kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organ kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi dihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017⁴, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe

⁴ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues

rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

22. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Vata, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

23. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 – 2016, dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, nga viti 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, dhe në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

25. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

26. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon:

26.1 Z. B.B., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur.

26.2 Z. L.V., dhe znj. K.V., (prindërit e subjekti) – konsiderohen persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi janë të rregjistruar në certifikatën familjare të subjektit.

organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

26.3 Znj. A.S. – motra e subjekti konsiderohet person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi është e regjistruar në certifikatën familjare të subjektit.

26.4 Z. A.J.S. – nipi i subjektit konsiderohet person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi është e regjistruar në certifikatën familjare të subjektit.

Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament banimi në Shkodër, me vlerë 23.475 lekë

1.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, apartament banimi në Shkodër, i regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistruar të Pasurisë të Paluajtshme Shkodër, me numër pasurie ***, vol. ***, f. ***, me sip. 78 m². Adresa e pasurisë lagja “****”, Rr. “****”, pallati nr. ***. Pasuria është blerë me kontratën paraprake të datës 6.12.1993, në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Çmimi i shitjes është paguar nga të ardhurat e familjes, pagesë e bërë me këste, në vlerën 250 lekë/muaj. Blerja e pasurisë është realizuar me kontratën noteriale nr. ***, datë 7.9.2001. Aktualisht apartamenti është në bashkëpronësi të shtetasve L.V., K.V. dhe Valbona Vata. Me cilësinë e bashkëpronarit ka qenë edhe vëllai subjektit (i ndjerë R.L.V.), i cili ka ndëruar jetë në datën 12.9.2007. Me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë me vendimin nr. ***, datë 14.1.2011, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pjesa takuese i ka kaluar dy trashëgimtarëve ligjor, prindërve L. dhe K.V. Bashkëpronarë të kësaj pasurie të vlerës 75% janë prindërit e subjektit të cituar me lart. Vlera: 23.475 lekë. Nuk është bërë rivlerësimi i pronës. Pjesa takuese: 25%. Si burim krijimi subjekti deklaron: me anë të privatizimit. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁵.

1.2. *Faktet nga hetimi administrativ kryesisht* - në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar shtëpi banimi (hyrje pallati 2+1, me sip. 78 m²), me adresë: lagjja “****”, Rr. “****”, pallati nr. ***. Burimi i krijimit: nga privatizimi i banesave shtetërore. Pjesa takuese: 25 %.

1.3. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Shkodër⁶, konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit, L.V. dhe K.V. është e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, e llojit apartament me sip.78 m² në Shkodër, me vlerë 23.475 lekë.

1.4. **Origjina e pronës** - babai i subjektit, z. L.V., në cilësinë e qiramarrësit ka lidhur me Ndërmarrjen Komunale Banesa kontratën për privatizimin e banesës, me pagesë 250 lekë/muaj. Më tej, me anë të aktit për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 7.9.2001, me palë shitëse Sektori i Privatizimit dhe palë blerëse shtetasit L.V., K.V., Valbona Vata dhe R.V., është përfituar apartamenti me sip. totale 78 m² ndodhur në katin e pestë, lagjja “****”, Rr. “****”, Shkodër.

1.5. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 14.1.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nëpërmjet të cilit është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin R.L.V., duke përcaktuar si trashëgimtar ligjor të radhës së dytë prindërit e tij L., dhe K.V., të cilët trashëgojnë nga ½ pjesë të pasurisë trashëgimore secili. Me anë të certifikatës së pronësisë, datë 10.2.2011, vërtetohet se kjo pasuri figuron në emër të shtetasve L.V., K.V., dhe Valbona Vata.

1.6. Në pyetësin nr. 1⁷, subjekti ka deklaruar se nga momenti i fillimit të detyrës në shtator të vitit 2000, deri në shtator 2017, ka banuar në këtë apartament. Kjo banesë është blerë në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Blerja e pasurisë është realizuar me kontratën noteriale nr. ***, datë 7.9.2001, sipas së cilës, prona ka qenë në pronësi të shtetasve L.V., K.V., R.V., dhe Valbona Vata, me nga 1/4 pjesë takuese secili.

⁵ Certifikatë vërtetimi pronësie për pasurinë nr. ***, datë 10.2.2011, kontratë privatizimi banese, akt shitblerje pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 7.9.2001, vendimi nr. ***, datë 14.1.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin R.L.V.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 13.11.2019.

⁷ E-mail datë 28.10.2019, ora 14:15.

1.7. Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë pasuri, nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

1.8. Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë apartament banimi në Shkodër, si dhe mënyrën e fitimit të pronësisë, ku subjekti i rivlerësimit është bashkëpronare me 25% të kësaj prone.

2. Apartament banimi me sip. 71.93 m², në Tiranë, me vlerë 6.300.000 lekë

2.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, apartament banimi në Tiranë. Kontratën e porosisë nr. ***, datë 24.12.2010, të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., për një apartament banimi (në ndërtim) të ndodhur në Rr. “****”, me sip. 71.93 m². Vlera e apartamentit është 6.300.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

2.2. Si burim krijimi subjekti deklaroi: shuma 1.300.000 lekë, paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës, burimi i të cilave është kursime të familjes së subjektit ndër vite. Pjesa tjetër e vlerës së objektit prej 5.000.000 lekësh është paguar në vitin 2011, me kredinë së marrë nga Banka Kombëtare Tregtare, në bazë të vendimit nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehë të nëpunësve civile të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, të Këshillit të Ministrave dhe të Urdhrit nr. 122, datë 4.6.2010, të Kryeministrit. Në datën 8.7.2011, subjekti ka nënshkruar si kredimarrëse kontratë kredie nr. ***, pranë Dhomës së Noterëve Tiranë. Kredihënëse është Banka Kombëtare Tregtare. Totali i shumës së kredituar 5.000.000 lekë. Afati i shlyerjes së kredisë është 180 muaj, shlyet çdo muaj, interes + principal. Me cilësinë e kredimarrësit, subjekti paguan interes në vlerën 4%. Shuma e kredituar në datën 28.7.2011 është derdhur nga Banka Kombëtare Tregtare në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., subjekt pranë të cilit është kryer blerja e pasurisë së paluajtshme, apartament banimi. Për vërtetimin e deklaratimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues⁸.

2.3. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht - në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar nënshkrimin e kontratës së porosisë nr. ***, datë 24.12.2010, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., për një apartament banimi me sip. 71.93 m² (në ndërtim), të ndodhur në Rr. “****”. Vlera e apartamentit është 6.300.000 lekë, nga të cilat janë paguar 1.300.000 lekë, burimi i të cilave është nga kursimet familjare ndër vite. Pjesa tjetër e vlerës së objektit prej 5.000.000 lekësh do të paguhej në vitin 2011, me anë të kredisë së marrë në Bankën Kombëtare Tregtare, në bazë të vendimit nr. 600, datë 12.9.2007 [...].

2.4. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Tiranë⁹, nuk figuron i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit apartament banimi me sip. 71.93 m², Tiranë. Ndërkohë OSHEE-ja¹⁰, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit, identifikohet një kontratë furnizimi me energji elektrike në Instancën e Tiranës, Rr. “****”, ***, instaluar në datën 3.4.2012.

2.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹¹, subjekti deklaroi se këtë pasuri nuk e ka të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe zotëron vetëm kontratën e sipërmarrjes.

2.6. Sipas kontratës së porosisë për apartamentin nr. ***, me sip. 71,93 m², kati i ***, Tiranë, me çmim 6.300.000 lekë, pagesa do të likuidohet me këste. Shuma 1.300.000 lekë është paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës. Kësti i dytë dhe i fundit prej 5.000.000 lekësh do të paguhet për llogari të sipërmarrësit me anë të kredisë që do të marrë porositësi nëpërmjet BKT-së deri në datën 25.1.2011.

2.7. Sipas kërkesës së Komisionit, shoqëria “****” sh.p.k.¹² ka vënë në dispozicion: (i) kontratën e porosisë nr. ***, datë 24.12.2010; (ii) kopje të mandatarkëtimit nr. ***, datë 24.12.2010, me vlerë 1.300.000 lekë, arkëtuar nga znj. Valbona Vata, me përshkrim “*prenotim apt. *** (kësti I)*”;

⁸ Kontratë porosie nr. ***, datë 24.12.2010; vërtetim nr. *** prot, datë 21.10.2016, i BKT-së; kontratë kredie bankare nr. ***, datë 8.7.2011, me palë kredihënëse Banka Kombëtare Tregtare dhe kredimarrëse Valbona Vata, të kredisë në shumën 5.000.000 lekë.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2019, nr. *** prot., datë 11.11.2019, nr. *** prot., datë 11.11.2019.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 29.10.2019.

¹¹ E-mail datë 24.11.2020, ora 14:07.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2020.

(iii) kopje të transfertës bankare, datë 28.7.2011, me vlerë 4.926.125 lekë, me përshkrim “Valbona L. Vata për shoqërinë ‘***’ sh.p.k., për pagesë për blerje apartamenti likuidim përfundimtar”.

2.8. Pas analizimit të vlerës së blerjes së këtij apartamenti, duket se nuk ka pasur ndonjë trajtim preferencial për subjektin e rivlerësimit. Referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2010”, rezulton se vlera reale e tregut për këtë apartament përlllogaritet në shumën 6.096.07 lekë (71.93 m² * 84.750 lekë/m²).

Lidhur me analizimin e burimit të krijimit

i) Shuma 1.300.000 lekë, kursimet e familjes ndër vite

2.9. Në pyetësonin nr. 1, subjekti deklaroi se: (1) në periudhën 2001 – 2007, ka bashkëjetuar me pjesëtarët e familjes, të përbërë nga babai, nëna, vëllai dhe motra (kjo e fundit gjatë periudhës tetor 2001 – shkurt 2006, afërsisht 10 muaj çdo vit, për shkak të studimeve dhe/ose punësimit, ka jetuar në ***, Austri). Shpenzimet e jetesës janë përballuar nga pensionet e prindërve, paga e subjektit, si dhe aktiviteti si tregtar ambulant i vëllait. Motra ka përfutur bursë, si edhe ka lidhur kontrata pune në Austri (***) (2) në periudhën 2001 – 2003, gjatë ushtrimit të detyrës në Korçë, ka qëndruar me qira dhe shpenzimet e jetesës janë përballuar nga paga e subjektit; (3) në periudhën 2008 – 2011, gjatë ushtrimit të detyrës në Tiranë, ka qëndruar me qira dhe shpenzimet e jetesës janë përballuar nga paga e subjektit (duke i ndarë ato me shtetasen A.B., me të cilën ka qëndruar në të njëjtin ambient); (4) gjatë vitit 2012, shpenzimet e jetesës në Tiranë, janë përballuar nga paga; (5) në periudhën 2013 – shtator 2017, gjatë ushtrimit të detyrës në Shkodër, shpenzimet e jetesës, janë mbuluar me pensionet e prindërve, pagën e subjektit dhe pagën e motrës (kjo e fundit, ka jetuar me familjen e subjektit deri në qershor të vitit 2013, kohë në të cilën ka filluar bashkëjetesën me shtetasin austriak Ch.S.); (6) prej shtatorit të vitit 2017 dhe aktualisht, shpenzimet e jetesës përballohen nga paga e subjektit dhe aktiviteti tregtar i bashkëshortit.

2.10. Duke qenë se subjekti ka deklaruar se burimi i shumës 1.300.000 lekë janë kursimet familjare ndër vite, Komisioni mori në analizë deklaratat periodike vjetore dhe vëren se në deklaratat periodike vjetore të viteve 2003 – 2009 subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit. Referuar nenit 4, pika “d”, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003¹³, i ndryshuar, subjektet mbartin detyrimin të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”, në këto kushte, subjekti duhet të kishte deklaruar shumën e kursimeve të tij në deklaratën periodike vjetore përkatëse.

2.11. Për sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare në datën 24.12.2010, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet vetëm për subjektin e rivlerësimit, nga ku rezultoi një balancë negative në vlerë 389,705 lekë.

ii) Shuma 5.000.000 lekë, kredi e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare

2.12. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar se në datë 8.7.2011, ka nënshkruar kontratë kredie bankare si kredimarrëse me nr. ***, me Bankën Kombëtare Tregtare. Totali i shumës së kredituar 5.000.000 lekë. Afati i shlyerjes së kredisë është 180 muaj, shlyet çdo muaj, interes + principal. Me cilësinë e kredimarrësit, paguan interes në vlerën 4%. Shuma e kredituar në datë 28.7.2011, është derdhur nga Banka Kombëtare Tregtare në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., subjekt pranë të cilit është kryer blerja e pasurisë se paluajtshme, apartament banimi.

2.13. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga Banka Kombëtare Tregtare¹⁴, evidentohet se subjekti ka lidhur kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 8.7.2011, me palë kredidhënëse Banka Kombëtare Tregtare dhe kredimarrëse Valbona Vata, të kredisë në shumën 5.000.000 lekë. Afati i

¹³ Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, me ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, me ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, dhe me ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2020.

shlyerjes së kredisë 180 muaj, normë interesi 4%. Dorëzanës të kësaj kredie janë shtetasit L.V., K.V., A.S., dhe M.H.

2.14. Në kontratë specifikohet që palët kanë rënë paraprakisht dakord që të lidhin këtë kontratë kredie në bazë të vendimit nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehë të nëpunësve civile të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, të Këshillit të Ministrave dhe Urdhërit nr. 122, datë 4.6.2010, të Kryeministrit.

2.15. Në pikën 2 të Aneksit, të çeljes dhe përdorimit të kredisë, specifikohet se kreditimi do të përdoret për blerje apartamenti dhe, më tej, në Aneksin e Elementeve Specifike të kredisë evidentohet se kredia e miratuar do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimi të blerjes së apartamentit dhe shuma e disburuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit të objektit të kredituar shoqërisë “****” sh.p.k., me transfertë bankarë nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare.

2.16. Komisioni konstaton së në datën 26.7.2011, është kryer disbursimi i shumës prej 4.950.000 lekësh në llogarinë e subjektit të rivlerësimit dhe, më tej, në datën 28.7.2011 është transferuar shuma prej 4.926.125 lekësh nga llogaria e subjektit në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrim “*Valbona L. Vata për shoqërinë “****” sh.p.k. për pagesë për blerje apartamenti likuidim përfundimtar*”.

2.17. Në lidhje me kolateralin e vendosur, në datën 8.7.2011 subjekti ka lidhur kontratën e hipotekimit nr. ***, duke vendosur në favor të bankës pasurinë apartament me sip. 85 m², në Shkodër, regjistruar në emër të shtetasve M.S.H. Në kartelën e pasurisë evidentohet shënimi ***, vlera 1.000.000 lekë. Nga verifikimi në sistemin multifunksional të ZVRPP-së, Komisioni vëren se ky apartament është blerë me anë të kontratës nr. ***, datë 27.10.1999, me palë shitëse B.S., dhe palë blerëse M.H., në shumën 1.000.000 lekë.

2.18. Më tej, në datën 25.8.2014 është lidhur një kontratë tjetër hipotekimi me nr. ***, ku janë hipotekuar pasuritë: (1) njësi me sip. 20.1 m², ndodhur në “****”, Shkodër, regjistruar në emër të shtetasve M.H., me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***; dhe (2) apartament me sip. 78 m² në Shkodër, regjistruar në emër të shtetasve Valbona, L., dhe K.V., me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***. Në kartelën e pasurisë evidentohet shënimi kurs këmbimi nr. ***, dt. 1.3.2010, pa vlerë.

2.19. Me pyetësorin nr. 1, subjekti u pyet lidhur me marrëdhënien e saj me shtetasen M.H. Në përgjigje, subjekti deklaron se me këtë shtetase ka miqësi familjare prej shumë vitesh.

2.20. Komisioni vëren se bazuar në vendimin nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehë të nëpunësve civile të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politike”, të Këshillit të Ministrave, në pikën 10 parashikohet: “*Kredia për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, jepet në vlerën deri në 5.000.000 lekë, me interes 4 për qind*”. Gjatë kësaj periudhe (17.12.2007 – janar të vitit 2013), subjekti ka qenë me detyrë në funksionin Kryeinspektore në KLD.

2.21. Lidhur me shlyerjen e kredisë, referuar analizës financiare, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare, ndër vite, për kryerjen e shpenzimeve, shtesën e kursimeve dhe shlyerjen e kësteve të kredisë.

2.22. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) ka mospërputhje lidhur në deklaratimet e subjektit për sa i përket burimit të shumës prej 1.300.000 lekësh, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti deklaron se burim i shumës prej 1.300.000 lekësh janë kursimet e familjes së subjekti, ndër vite, ndërkohë që në deklaratat periodike vjetore subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*; (ii) subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën -389.705 lekë për kryerjen e pagesës së kështit, blerjen e automjetit dhe shpenzimeve të tjera.

2.23. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se burimi i pagesës së kështit në vlerën 1.300.000 lekë, janë kursimet familjare, fakt ky i deklaruar në DPV-në e vitit 2010, konfirmuar edhe në deklaratën *Vetting*. Subjekti shpjegon se ka qenë në një trung me familjen e origjinës deri në datën 9.12.2017 dhe kërkon që analiza financiare të përfshijë të ardhurat dhe shpenzimet familjare, në tërësi (në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, në trungun familjar kanë qenë babai, nëna dhe motra e subjektit, e cila në atë periudhë ndodhej në Austri).

Më tej, deklaroi se Komisioni në disa raste konstaton se diferencat negative të evidentuara në analizën e familjes së saj, mbulohen nga të ardhurat e subjektit, si dhe mundësia për kursim duke filluar nga viti 2001, ku vetëm në vitin 2009 ka qenë në shumën 1.101.413 lekë.

2.24. Subjekti sqaron se në deklaratat periodike të pasurive, nuk ka deklaruar gjendje *cash*, pasi këto likuiditete nuk i dispononte fizikisht, por familja e saj dhe nuk ka deklaruar gjendjen e kursimeve familjare, pasi ligjërisht familjarët e saj nuk kanë pasur detyrim për të deklaruar dhe se mosdeklarimi i kursimeve familjare, nuk ka qenë i qëllimshëm apo për arsye të fshehjes së tyre. Të ardhurat prej periudhës shtator 2000 – dhjetor 2010, kohë në të cilën është paguar kësti i parë i blerjes së apartamentit, janë të konsiderueshme dhe jo vetëm që mbulojnë shpenzimet jetike por justifikojnë edhe kursimet, të cilat janë përdorur për të paguar këtë këst. Në përfundim subjekti thekson se të ardhurat janë krijuar nga paga e saj dhe kursimet e familjes së origjinës, prandaj analiza financiare duhet të rishikohet duke marrë në konsideratë të ardhurat/kursimet familjare, deri në momentin kur është blerë kjo pasuri, në raport me shpenzimet dhe në respektim të standardit kushtetues “*dyfishi i pasurisë së ligjshme*” .

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.25. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

2.26. Në këndvështrim të analizimit të detyrimeve ligjore për të provuar bindshëm ligjshmërinë e krijimit të pasurisë, Komisioni, pasi analizoi deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, vëren se ky i fundit, synon të provojnë faktin se kursimet *cash* i janë kaluar për administrim babait të saj dhe, për pasojë, nuk janë poseduar e zotëruar më prej saj, prandaj dhe nuk i ka deklaruar ato në deklaratat periodike vjetore.

2.27. Në këto kushte, Komisioni, pasi mori në konsideratë se në DPV-në e vitit 2010 dhe deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se burimi i shumës prej 1.300.000 lekë, janë kursimet e familjes, ndër vite, del në **përfundimin se** në analizën financiare të datës 24.12.2010 duhet të konsiderohen të ardhurat e anëtarëve të familjes, sikundër ka pretenduar subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, balanca negative nga -389.705 lekësh, ndryshon në vlerën -152.149 lekë¹⁵, pa marrë fare në shqyrtim kursime të mundshme që mund të kishin prindërit e subjektit referuar shpjegimeve të paraqitura në prapësime.

2.28. Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit për vitin 2010 rezulton me balancë negative për të ardhurat, pasuritë, shpenzimet dhe detyrimet në vlerën 152.149 lekë

2.29. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie, në raport me provat e tjera të administruara nga hetimi, Komisioni vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave, si detyrimi kryesor kushtetues.

¹⁵ Analiza financiare e saktësuar me: (1) shtuar të ardhurat babai nga pensioni në vlerën 196.488 lekë; (2) shtuar të ardhurat nëna nga pensioni në vlerën 206.400 lekë; (3) shtuar të ardhurat motra nga pagat në vlerën 305.753 lekë; (4) rritur shpenzimet jetike me 402.004 lekë; (5) rritur shpenzimet e udhëtimeve jashtë sipas sistemit *TIMS* me 55.524 lekë; (5) shtim i llogarive bankare me 13.557 lekë.

2.30. Në përfundim, Komisioni vlerëson se pavarësisht mungesës së burimeve të ligjshme në vlerën 152.149 lekë, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dhe të përbëjnë për pasojë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

3. Automjet tip “Passat”, me targa *, me vlerë 320.000 lekë**

3.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, autoveturë tip “Volkswagen”, me targa ***, e regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Shkodër në datën 25.11.2010. Autovetura është blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.9.2010. Pala shitëse në kontratë është Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Blerë me të ardhurat nga paga ime në vlerën 320.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaron të ardhurat nga paga. Për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁶.

3.2. *Faktet nga hetimi administrativ kryesisht* - në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar autompjet tip “Volkswagen”, me targa ***, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.9.2010, me çmim 320.000 lekë, pala shitëse Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

3.3. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.9.2010, me palë shitëse Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit, për automjetin tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi 2003, me targa ***. Çmimi i blerjes së mjetit 320.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës së noterisë me transfertë bankare. Sipas nxjerrjes së llogarisë bankare nga “Raiffeisen Bank”, për periudhën 7.1.2008 – 30.12.2016, rezulton se subjekti në datën 28.9.2010, ka bërë pagesën e vlerës 320.000 lekë për llogari të KLD-së.

3.4. Sipas dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja¹⁷, ky automjet nuk është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit. Nga kontrolli i kryer në AMF, rezulton se automjeti është në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit. z. B.B.,¹⁸ figuron posedues prej vitit 2012. Më tej, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së¹⁹, Komisioni vëren se automjeti figuron i regjistruar në emër të subjektit. Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 8.10.2010, të KLD-së, vërtetohet se automjeti tip “Volkswagen-Passat”, me targa *** në pronësi të KLD-së, është shitur në ankandin e zhvilluar në datën 17.9.2010, ku u shpall fitues znj. Valbona Vata me shumën 320.000 lekë. Ky automjet me targa *** (***) është regjistruar në emër të subjektit në datën 25.11.2010.

3.5. Në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”²⁰, konstatohet se në datën 28.9.2010, subjekti ka kryer një transfertë në shumën 320.000 lekë në favor të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me përshkrim “*Këshilli i Lartë i Drejtësisë 1161160 te ardhura nga shitja - të ardhura nga shitje automjete*”.

3.6. Komisioni vëren se vlera e transferuar ka si burim kreditimet në llogarinë e subjektit nga pagat, të cilat gjatë periudhës 1.1.2010 – 28.9.2010, kanë qenë në shumën 1.245.028 lekë.

3.7. Lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit, Komisioni i përfshiu shpenzimet për blerjen e këtij automjeti në analizën financiare të datës 24.12.2010.

3.8. Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë pasuri nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

3.9. **Si konkluzion**, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë automjet.

4. Konstatime të tjera gjatë hetimit administrativ

¹⁶ Kontratë shitblerje mjeti nr. ***, datë 29.9.2010, nxjerrja e llogarisë bankare nga “Raiffeisen Bank”, për subjektin Valbona Vata, për periudhën 7.1.2008 – 30.12.2016.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019.

¹⁸ Subjekti ka lidhur martesë në datën 9.12.2017.

¹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 17.5.2018, lëshuar nga DPSHTRR-ja.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 22.10.2019.

Deklarimi i llogarive bankare ndër vite

4.1 Në dokumentacionin e administruar nga bankat, kontsatohet se në datën 26.1.2017 (data e plotësimit të deklaratës *Vetting*), subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur gjendje likuiditetesh në llogari bankare si në vijim, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*:

- subjekti, llogari bankare (e pagës) në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 22 lekë;
- subjekti, llogari bankare (e kredisë) në BKT, në vlerën 578 lekë;
- motra e subjektit, llogari bankare në BKT, në vlerën 17.739 lekë;
- babai i subjektit, llogari bankare (e pagës) në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 166.236 lekë.

4.2 Më tej, në deklaratat periodike vjetore konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar këto llogari bankare në emër të saj.

4.3 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime mbi konstatimin se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar llogaritë bankare në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, si dhe burimin e tyre.

4.4 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se pasaktësitë në deklarimet periodike duke mos deklaruar llogaritë bankare dhe burimin e tyre nuk ka qenë të qëllimshme dhe se burimi i tyre është i ligjshëm, nga pagat dhe honoraret, të cilat janë deklaruar rregullisht në DPV-të përkatëse. Më tej, subjekti i rivlerësimit deklaroi se bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, (vendimet nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018, dhe nr. 5/2019 (JR), datë 18.02.2019), pasaktësitë në DPV nuk mund të penalizojnë subjektin e rivlerësimit, si shkak i veçuar, pasi lidhen me deklarimet periodike të saj.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.5 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

4.6 Pretendimi i subjektit se mosdeklarimi i këtyre llogarive nuk ka qenë i qëllimshëm nuk qëndron, pasi Komisioni nuk heton qëllimin e subjektit të rivlerësimit se përse nuk e ka deklaruar, por vërtetësisë e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

4.7 Sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës: “*Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet deklaratës dhe kontrollit të pasurive të tij, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikoheshin ligjërisht, ose ato që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.*”

4.8 E parë nga pikëpamja e kontrollit të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe në përputhje me ligjin llogaritë bankare që ajo dhe personat e lidhur dispononin si likuiditet në bankë. Ndërsa në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre llogarive, Komisioni arrin në përfundimin e subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e tyre.

4.9 Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar saktësisht këto llogari rrjedhëse dhe ndodhen në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33. të ligjit nr. 84/2016. Gjithsesi kjo pasaktësi nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut shkarkimi për subjektin e rivlerësimit.

PASURITË E MOTRËS SË SUBJEKTIT – A.S.,

5. Automjeti tip “Daimler –Benz”, me targa ***

5.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, personi i lidhur ka deklaruar, automjet i markës “Daimler Benz”, viti i prodhimit 1999, i blerë në datën 4.4.2009. Automjeti i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Transportit Rrugor Shkodër, me targa ***. Dhuratë për ditëlindje nga motra ime Valbona L. Vata. Çmimi i blerjes së këtij automjeti është 1.400 euro. Taksa doganore e paguar në datë 19.4.2009, në vlerën 197.538 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi personi i lidhur deklaroi: dhuratë për ditëlindje nga motra Valbona Vata. Për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²¹.

5.2. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht - në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar një kontratë të thjeshtë (jo e lidhur para noterit publik) të datës 4.4.2009, për shitblerjen e një makine të përdorur me çmim shitje 1.400 euro, me palë shitëse A.W., dhe palë blerëse A.V. Shpenzimet doganore në vlerën 197.538 lekë. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se në vitin 2009 i ka dhuruar motrës së saj automjetin tip “Daimler Benz”, me targa ***, viti i prodhimit 1999, blerë në datën 4.4.2009. Çmimi i blerjes 1.400 euro (paguar dorazi), taksa doganore janë paguar në datën 19.4.2009, në vlerën 197.538 lekë.

5.3. Sipas dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja²², ky automjet nuk figuron i regjistruar në emër të personit të lidhur, znj. A.S., ndërkohë që nga kontrolli i kryer në AMF, rezultoi se ky automjet ka qenë në pronësi të shtetasës A.S. Më tej, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së²³, Komisioni vëren se automjeti me targa *** rezultoi i regjistruar në emër të shtetasës A.S., nga 22.4.2009 –24.11.2017. Ky automjet me anë të kontratës nr. ***, datë 7.8.2017, është shitur nga personi i lidhur në vlerën 100.000 lekë.

5.4. Komisioni vëren se në deklaratën *Vetting* është deklaruar gabimisht targa *** për këtë automjet, pasi kjo targë i përket automjetit tip “Volkswagen- Passat” në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që sipas DPSHTRR-së, në emër të personit të lidhur, znj. A.S. (V.), rezultoi i regjistruar automjeti me targa *** (***) .

5.5. Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit në datën 19.4.2009, nga ku rezultoi një balancë pozitive në shumën 291.562 lekë.

5.6. Gjithashtu, konstatohet se në datën 7.4.2009, subjekti ka kryer një tërheqje në shumën 440.000 lekë nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank”.

5.7. Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë pasuri nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

5.8. Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur/motra e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë automjet dhe ka burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

6. PASURITË E BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT – B.B.,

6.1 Komisioni konstaton se në DPV-në e vitit 2017, subjekti figuron i ndarë nga certifikata familjare dhe me statusin martuar me shtetasin B.B. Në pyetësin standard subjekti deklaroi se në datën 9.12.2017, ka lidhur martesë me shtetasin B.B., dhe që nga ajo datë, familja përbëhet nga bashkëshorti dhe subjekti. Më tej, deklaroi se që nga fillimi i shtatorit të vitit 2017, përdor banesën në të cilën bashkëshorti është bashkëpronar, si dhe automjetin me targa ***, në pronësi të tij. Gjithashtu, deklaroi se me shtetasin B.B. ka udhëtuar në prill të vitit 2015, në Austri, në korrik të vitit 2016 në Gjermani, si dhe në shtator të vitit 2017 në Mal të Zi. Nga kqyrja e AMF-së shtetasi B.B., figuron përdorues i automjetit me targa ***, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, referuar policës nr. ***, datë 23.11.2011. **Për sa rezultoi,** Komisioni pa të nevojshme të hetojë lidhur me të ardhurat dhe mundësitë financiare të këtij shtetasi.

²¹ Kontratë, datë 4.4.2009, me palë shitëse A.W., dhe palë blerëse A.V., me çmim shitje 1.400 euro; kopje të deklaratës doganore nr. ***, datë 19.4.2009, ku evidentohen detyrimet doganore në shumën 197.538 lekë.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2018, lëshuar nga DPSHTRR-ja.

6.2 Në hetimin e tij, Komisioni u bazua në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2017, ku personi i lidhur, z. B.B., deklaroi se posedon të regjistruara në emrin e tij pasuritë e trajtuara, si vijon :

1) *Tokë arë, me sip. 1.000 m², ndodhur në ***-Plazh*

6.3 Pasuri e pajuajtshme tokë arë, me sip. 1.000 m², me nr. 1094/39, ndodhur në ***- Plazh, z. k. ***, vol. ***, f. ***, blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 11.1.2015, për shumën totale 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 25%. Si burim krijimi subjekti deklaroi kursimet nga aktiviteti si person fizik.

2) *Automjeti tip “Daimler-Benz”, me targa ***, vlera 800.000 lekë*

6.4 Autoveturë, tip “Daimler-Benz”, viti i prodhimit 1997, me targa ***, blerë me kontratën nr. ***, datë 17.10.2008, vlera 800.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

3) *Automjeti tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, vlera 300.638 lekë*

6.5 Autoveturë, tip “Daimler Chrysler E220 CDI”, viti i prodhimit 2003, me targa ***, blerë me kontratën e datës 31.3.2018, vlera 1.700 euro, çmimi i shitjes dhe 76.400 lekë tarifa doganore. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaroi kursimet nga aktiviteti si person fizik.

4) *Gjendje cash, shuma 1.500.000 lekë*

6.6 Në DPV-në e vitit 2017, dorëzuar në datën 30.3.2018, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1.500.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Si burim krijimi subjekti deklaroi kursimet nga të ardhurat si person fizik.

5) *Llogari rrjedhëse në “ProCredit Bank”, vlera 442.809,20 lekë*

6.7 Llogari rrjedhëse në “ProCredit Ban” deri në datën 26.3.2018, në shumën 442.809,20 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaroi të ardhurat nga aktiviteti si person fizik.

6) *Pasuri e paluajtshme në posedim ndodhur në Shkodër*

6.8 Në DPV-në e vitit 2017, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se është posedues i pasurisë së paluajtshme të regjistruar në emër të babait të tij të ndjerë D.B., në bazë të akteve të pronësisë nr. ***, datë 4.11.1971 dhe nr. ***, datë 12.11.1971, e përbërë nga shtëpi, oborr, etj, e trashëguar. Në këtë pasuri D.B., me lejen e sheshit të ndërtimit nr. ***, datë 12.3.2005, dhe lejen e ndërtimit nr. ***, datë 4.4.2005, të Bashkisë Shkodër, ka ndërtuar një shtëpi banimi me 2 e ½ kat, me sip. ndërtimi 115 m². Personi i lidhur deklaroi nuk është pasqyruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme vlera e këtyre dy pasurive. Pjesa takuese: në pritje të lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin D.B. Si burim krijimi subjekti deklaroi ndërtuar me kursimet e familjes nga puna në aktivitet privat.

6.9 Nga hetimi administrativ kryesisht në lidhje me pasuritë e mësipërme, Komisioni nuk konstatoi problematika në aspektin deklarativ që lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit znj. Valbona Vata.

7. Lidhur me analizimin e mundësive financiare të bashkëshortit të subjektit për krijimin e pasurive përpara martesë

7.1. Gjithashtu, Komisioni hetoi mundësitë financiare të bashkëshortit të subjektit, sipas dokumentacionit provues për shoqërinë “****”²⁴ dhe aktivitetit të bashkëshortit si person fizik²⁵, si dhe kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

7.2. Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në përgjigje²⁶ konfirmon se pas kërkimit në sistemin *c@ts*, në emër të z. B.D.B., i datëlindjes 6.2.1966, me ID ***, rezultojnë të regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër tatimpaguesit: (1) Tatimpaguesi B.B., me NIPT ***, me administrator z. B.B., me ID *** me status ligjor “Person Fizik”, me objekt “Tregtim mishi, kasap”, me adresë ushtrimi aktiviteti lagjia “****” (zona *** dhe ***), Shkodër, i regjistruar në datën 17.1.2003 dhe aktualisht në status aktiv, për të cilin ka përcjellë informacion dhe dokumentacion lidhur me qarkullimin gjatë viteve 2006, 2008 – 2019 dhe lidhur me fitimin e realizuar gjatë viteve 2008-2019; vendim gjykate nr. ***, datë 25.2.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për regjistrimin si person fizik të z. B.B., si tregtues mishi; vendim gjykate nr. regj. ***, datë 22.6.2006, për ushtrim aktiviteti “tregti mishi” dhe “bar kafe” si person fizik; si edhe dokumentacion shoqërues në lidhje me deklarimin e qarkullimit/fitimit. (2) Tatimpaguesi B.B., me NIPT *** me administrator z. B.B., me ID *** me status ligjor “Person Fizik” me objekt “Matching, finance, imobiliare, shërbime punësime”, me adresë ushtrimi aktiviteti lagjia: “****”, Rr. “****”, godinë ***-katëshe, kati i parë, Shkodër, i regjistruar në datën 22.1.2018 dhe është në statusin kërkesë për çregjistrim që nga data 19.3.2018.

7.3. Në përmbledhje, vetëm për periudhën 2006 – mars 2018, fitimi i realizuar ka qenë në shumën 3.267.904 lekë.

7.4. Si konkluzion, në lidhje me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e bashkëshortit të subjektit, Komisioni, pasi i hetoi në mënyrë gjithëpërfshirëse, vlerëson se nuk ka indicie të cilat mund të ngrenë dyshime për pasuri të fshehur/a të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ndikojnë në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit. znj. Valbona Vata.

8. Analiza financiare

8.1. Komisioni kreu analizën për periudhën 2001 – 2018, duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, nga ku të gjitha vitet rezultuan me balanca pozitive, me përjashtim të balancës negative të vitit 2010, e trajtuar më lart në paragrafët 2.9 – 2.30.

²⁴ (1) dëftesë arkëtimi nr. *** i Bankës së Shqipërisë, datë 05.07.1993, ku rezultojnë të jetë paguar tatim fitimi për Firmën ***, vlerën 6.000 lekë, nga B.B., për periudhën mars-qershor 1993; (2) dëftesë arkëtimi nr. *** i Bankës Kombëtare Tregtare, datë 16.12.1995, ku rezultojnë të jetë paguar tatim fitimi për “Firmën ****” me nr. ***, me numër llogarie ***, në vlerën 10.000 lekë për tremujorin e IV 1995; (3) tre fletëdalje të **** Shkodër, me nr. llogarie ***, me numrat respektivë: ***, datë 16.12.1992, me marrës në dorëzim B.B.; ***, datë 17.12.1992, me marrës në dorëzim B.B.; ***, datë 18.12.1992, me marrës në dorëzim B.B.; (4) leje higjieno-sanitare nr. ***, datë 5.11.1998, për ushtrim aktiviteti nga B.B., në lagjen “****”, Shkodër; (5) shkresë nr. *** prot, datë 5.2.2004, e Inspektoratit të Mjedisit Shkodër për subjektin “Firma ****”, me aktivitet “Kompleks Blegtoral” B., për tërheqjen e lejes mjedisore; (6) kontratë shitje, datë 17.3.1999, me palë shitëse Firma ****, e përfaqësuar nga B.B., me Repartin *** F.N.Sh., ku në bazë të rregullave të prokurimit publik sipas ligjit nr. 7971, datë 26.7.1995, është lidhur kontrata për furnizim me mish të freskët në vlerën 1.650.000 për periudhën 17.3.1999 deri më 31.12.1999 dhe formulari i sigurimit të kontratës datë 12.3.1999; (7) leje mjedisore sipas shkresës me nr. *** prot., për lejen nr. ***, datë 6.11.2002, “për rritje dhe mbarështrim viçash” për B., dhe B.B.

²⁵ (1) shkresë nr. *** prot., datë 20.11.2020, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, ku janë vënë në dispozicion të dhënat që ekzistojnë nga sistemi *c@ts* të kësaj drejtorie për subjektin tatimpagues B.B., me NIPT ***, i regjistruar me vendim gjykate nr. ***, datë 22.2.2006. Në këtë vërtetim pasqyrohet se në këtë dosje ndodhet dhe një tjetër vendim gjykate, nr. ***, datë 25.2.1999, për regjistrimin si person fizik, por pa të dhëna në sistemin *c@ts*; (2) mandatarëkëtimi nr. ***, i Drejtorisë Postare Shkodër, me të cilin, me datë 20.1.2000, është paguar tatim nga B.B., për vitin 1999, në vlerën 40.000 lekë; (3) mandatarëkëtimi nr. ***, i Drejtorisë Postare Shkodër, me të cilin në datën 20.1.2000, janë paguar sigurimet shoqërore nga B.B., për vitin 1999, në vlerën 32.340 lekë; (4) mandatarëkëtimi nr. ***, i Postës Shqiptare me të cilin, në datën 6.2.2004, është paguar nga B.B., me nr. licence ***, tatim fitimi për vitin 2003, në vlerën 34.540 lekë; (5) mandatarëkëtimi nr. ***, i Postës Shqiptare me të cilin në datën 6.2.2004, është paguar nga B.B., me nr. licence ***, tatim fitimi për vitin 2004 dhe taksa vendore, në vlerën 47.800 lekë; (6) vërtetim nr. *** prot, datë 17.3.2004, i Degës së Tatimeve Shkodër, nga ku rezultojnë se B.B., me kod fiskal ***, për ushtrimin e aktivitetit privat tregti mishi ka shlyer detyrimet tatimore për vitin 2003 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2004.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2020.

8.2. Më tej, Komisioni kreu analizën për periudhën 2001 – 2013, duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e prindërve dhe motrës së subjektit të rivlerësimit dhe për periudhën 2014 – 2017, duke marrë në konsideratë pasuritë, të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet e prindërve të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi një balancë negative në vlerën 92.271 lekë për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2008.

8.3. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se personat e lidhur/prindërit dhe motra kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për vitin 2008 në vlerën -92.271 lekë për kryerjen e shpenzimeve.

8.4. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se duke qenë se për vitin 2008 referuar analizës financiare, rezultoi me balancë pozitive, duhet të merret në konsideratë i njëjti argumentim edhe në rastin e balancës negative të familjes për vitin 2008. Subjekti theksoi se në vijimësi ka deklaruar se përballimi i shpenzimeve ka qenë nga të ardhurat familjare, pra, edhe kursimet duhet të konsiderohen si të tilla nga Komisioni.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

8.5. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

8.6. Nëse analiza financiare do të kryhet për të gjithë familjen së bashku, balanca në fund të vitit kalendarik do të rezultonte pozitive, me përjashtim të vitit 2010 (trajtuar më lart).

8.7. Në përfundim, Komisioni, pasi analizoi të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet, del në konkluzionin që personat e lidhur kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

2. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin, nr. ***, datë 12.12.2019, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

3. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

4. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Vata.

5. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

6. Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me 24 personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

7. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. **Si konkluzion**, Komision vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti Tiranës në datën 14.9.1996 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2001. Pas studimeve ka punuar si ndihmës gjyqtare për periudhën 30.3.1995 – shtator 1998, ku fitoi konkursin e Shkollës së Magjistraturës. Në datën 2.10.2001, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Më pas, në datën 11.10.2003, transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në vazhdim, emërohet Kryeinspektore në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë me vendimin nr. ***, datë 17.12.2007, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 18.1.2013, pasi është dekretuar si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku vazhdon dhe aktualisht.

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve e tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

3. Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, lidhur me kriteret e vlerësimit, sipas ligjit nr. 96/2016, janë vënë re këto gjetje:

4. Lidhur me aftësitë profesionale

4.1 Njohuritë ligjore – subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, ka njohuritë bazë mbi parimet e përgjithshme të aksesit në gjykatë, pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të drejtën e mbrojtjes dhe të kontradiktoritetit. Megjithatë, verëhet se subjekti nuk përdor rregullisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës. Në një rast, përmend parimin e sigurimit të një mbrojtje efektive joformale për të pandehurin në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Në këtë rast përmendja e këtij parimi nuk ka qenë vetëm si njohuri teorike e saj, pasi në tekstin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është konsideruar si shkelje procedurale fakti që gjykata e shkallës së parë nuk ka garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor për t’i siguruar të pandehurit mbrojtje me avokatë të paanshëm (mes të pandehurve ka pasur papajtueshmëri interesash dhe nuk mund të mbroheshin nga i njejtë avokat neni 54/1 i Kodit të Procedurës Penale), duke prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çeshtjes për rigjykim, në një rast tjetër është trajtuar edhe parimi i papanësisë së gjykatës, duke duke prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çeshtjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

Nga dosjet e analizuara rezulton se vetëm ndaj një vendimi është ushtruar e drejta e rekursit por edhe në këtë rast nuk mund të nxirren konkluzione, pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur ende.

4.2 Arsyetimi ligjor – subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme, respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Vendimet e ndërmjetme përgjithësisht nuk arsyetohen ose kanë arsyetim minimal, si dhe nuk kanë referenca ligjore, me përjashtim të rasteve të vendimeve të ndërmjetme për gjykimin në mungesë, të cilat janë arsyetuar dhe ka referencë ligjore. Vendimet përfundimtare janë strukturuar sipas elementëve të kërkuar nga ligji procedural, duke ruajtur strukturë të standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur subjekti i rivlerësimit. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës dhe respektimit të normës ligjore nga gjykatat më të ulëta dhe kur është rasti identifikon shkeljen me pasojë prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, pasi nuk është siguruar zhvillimi i një prooçesi të rregullt ligjor. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor.

5. Lidhur me aftësitë organizative

5.1 Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë – subjekti rivlerësimit, znj. Valbona Vata, sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Apelit Shkodër për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka përfunduar 985 çështje, nga të cilat 204 çështje penale, 399 çështje civile të përgjithëshme, 285 kërkesa penale dhe 97 kërkesa civile.

5.2 Aneksi 1 i Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, nuk jep standarde minimale për gjyqtarin e gjykatës së apelit që nuk është e organizuar në seksione. Germat “h” dhe “i”, të pikës 3, vendosin standartet minimale prej 150 gjykimesh penale për relator në dhomën penale dhe 200 gjykime çështjesh civile për relator në dhomën civile. Në këto rrethana, nëpërmjet metodës së interpretimit, është nxjerrë si standard numri prej 200 gjykimesh penale dhe civile për gjyqtarin e gjykatës së apelit, që nuk është e organizuar në seksione. Këto rregulla në rastin e subjektit Valbona Vata nënkuptojnë një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Duke iu referuar të dhënave statistikore, konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin minimal.

5.3 Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve përgjithësisht ka qenë brenda afatit standard apo ligjor. Në përlllogaritjen e kohës efektive të mbajtjes për gjykim të dosjes nga gjyqtarja është përlllogaritur data e shpalljes së listës së gjykimeve nga kryetari i gjykatës, me të cilën caktohet seanca e parë gjyqësore.

5.4 Në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimit duhet evidentuar se nga 6 ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës Valbona Vata, gjatë periudhës së rivlerësimit, konstatohen se vetëm 1 ankesë e vitit 2014, është për zvarritje gjykimi dhe mosrespektimin formal të ligjit, e cila pas verifikimit është arkivuar, pasi pretendimet janë gjetur të pabazuara. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive.

5.5 Është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Në rastet e vëzhguara janë respektuar përgjithësisht afatet standarde të gjykimit. Lidhur me kohën e arsyetimit të vendimeve, në 2 raste nga 5 dosje të vëzhguara gjithsej, është tejkaluar afati ligjor, por ky tejkalimi ka qenë disa ditë dhe në asnjë rast përtej afatit të rekursit.

5.6 Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore – dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa (*menjëherë pas caktimit të seancës së parë gjyqësore nga kryetari i gjykatës me listën e shpallur*). Në çështjet penale subjekti disponon me urdhër thirrje për palët duke caktuar datën që është përcaktuar nga kryetari i gjykatës në listën e shpallur.

5.7 Në dy raste vonesat në fillimin e seanceve gjyqësore kanë qenë të papërfillshme, ndërkohë në dy raste të tjera, vonesat kanë qenë nga 16-37 minuta. Megjithatë, vonesa në fillimin e seanceve nuk ka penguar ecurinë e gjykimit.

5.8 Gjatë gjykimit, subjekti identifikon veprimet procedurale që duhen kryer, merr mendimin e palëve për to, dhe disponon me vendimet e ndërmjetme. Në rastet kur është vendosur gjykimi në mungesë të palës, vendimi ka qenë i arsyetuar dhe përgjithësisht me referencë ligjore.

5.9 *Aftësia për të administruar dosjet* – nga vëzhgimi i dosjeve gjyqësore nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikqyrur saktësinë e akteve që përfshihen në të.

6. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

6.1 *Etika në punë* – sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, janë paraqitur gjithsej 6 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së (2 në vitin 2013, 3 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016). Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Valbona Vata përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

6.2 *Integriteti* – nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

6.3 *Paanësia* – nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Vata. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve.

7. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

7.1 *Aftësitë e komunikimit* – konstatohet se komunikimi i subjektit të rivlerësimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

7.2 *Aftësia për të bashkëpunuar* – në dosjet e vëzhguara është konstatuar se bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore përgjithësisht ka qenë në nivelin e duhur dhe nuk janë konstatuar vonesa domethënëse në depozitimim e dosjes në sekretarinë gjyqësore.

7.3 *Gatishmëria për t'u angazhuar* - subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, pas diplomimit “Jurist” në vitin 1988, në vitin 2001 ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës. Në vitin 2015-2016 ka qenë pedagoge e jashtme në Shkollën e Magjistraturës në lëndën “E drejta familjare”. Për shkak të funksionit që kryen, subjekti i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë si eksperte në 12 aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe ka qenë pjesëmarrëse në 13 aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Lënda e trajnimeve lidhet me të drejtën ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, të drejtën administrative, drejtën penale dhe civile.

8. TË DHËNAT ARKIVORE

8.1 Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për subjektin Valbona Vata, janë paraqitur gjithsej 6 ankesa në Inspektoratin e ish-KLD-së (2 në vitin 2013, 3 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016): 1 ankesë e vitit 2016 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor; 5 ankesa të tjera janë verifikuar dhe rezultatoi se 2 ankesa (1 e vitit 2013 dhe 1 e vitit 2014) janë verifikuar bazuar në informacionin periodik ardhur nga kryetari i gjykatës në lidhje me mosdorëzimin në afat të vendimeve të arsyetuara, i janë regjistruar gjyqtarës për efekt të vlerësimit profesional dhe etik; 1 ankesë e vitit 2013 verifikuar për mosrespektim formal të ligjit është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara; 1 ankesë e vitit 2014 është verifikuar bazuar në informacionin periodik ardhur nga kryetari i gjykatës dhe është arkivuar pasi pretendimet janë të pabazuara; 1 ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit dhe është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, ndaj subjektit Valbona Vata përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

8.2 Më tej, Komisioni kërkoi informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj saj, nga viti 2006 dhe deri më sot. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 23.6.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, vëren se janë depozituar 7 ankesa. Ndërkohë, sipas shkresës nr. *** prot., datë 14.8.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se ndaj subjektit Valbona Vata janë depozituar 13 ankesa.

8.3 Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara në KLD dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore, të analizuar nga KLGJ-ja, vlerëson se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

9. DENONCIMET NGA PUBLIKU

9.1 Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Valbona Vata, janë administruar denoncime nga publiku, si vijon: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 23.1.2018, i shtetases A.N., e cila ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 26.1.2018, i shtetasit V.P., i cili ankohet për 13 subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe për subjektin Valbona Vata, për gjykime të padrejta; (3) denoncimet nr. *** prot., datë 26.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 15.3.2018, të shtetasit A.B., i cili ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë; (4) denoncimi nr. *** prot., datë 20.4.2018, i shtetasit R.D., i cili ankohet për 18 subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe për subjektin Valbona Vata, duke i akuzuar si të korruptuar; (5) denoncimet nr. *** prot., datë 14.5.2018 dhe nr. *** prot., datë 15.5.2018, të shtetases E.Sh., e cila ankohet se subjekti i rivlerësimit ka zbardhur një vendim tjetër nga ai çka kishte deklaruar gojarisht, duke e dorëzuar atë ditën që skadonte e drejta e apelit, në mënyrë që të favorizohej pala tjetër në gjykim; (6) denoncimi nr. *** prot., datë 26.10.2018, i paraqitur nga shtetasi D.P., i cili kërkon verifikimin e vendimit penal nr. *** , datë 20.8.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhënë nga gjyqtarët Valbona Vata, S.K., dhe A.N.,; (7) denoncim nr. *** prot., datë 1.11.2018, i paraqitur nga shtetasja M.N., e cila ankohet për 12 subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se i është mohuar e drejta nga veprimet e vendimet korruptive të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë; (8) denoncimet nr. *** prot, datë 20.12.2018, dhe nr. *** prot, datë 6.1.2018, të shtetases V.N., e cila ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë dhe zvarritje të procesit gjyqësor; (9) denoncimi nr. *** prot., datë 27.12.2018, i paraqitur nga shtetasi Z.P., i cili ankohet se subjekti i rivlerësimit si pjesë e trupës gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka dhënë një vendim të padrejtë (vendimin nr. *** , datë 13.2.2014); (10) denoncimi nr. *** prot., datë 8.1.2019, i paraqitur nga shtetasi P.Ll., i cili ankohet për 18 subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe Valbona Vata, duke i akuzuar për shpërdorim detyre me dashje dhe fshehje të krimit të organizuar; (11) denoncimet nr. *** prot., datë 20.3.2019, nr. *** prot., datë 17.4.2019 dhe nr. *** prot., datë 19.6.2019 të shtetasit I.M., i cili e akuzon subjektin e rivlerësimit për korrupsion dhe favorizim të palës tjetër në gjykim; (12) denoncimi nr. *** prot., datë 4.4.2019 të shtetasit B.Sh., i cili e akuzon subjektin e rivlerësimit për paaftësi profesionale dhe zvarritje të procesit gjyqësor ku ai është palë në gjykim; (13) denoncimi nr. *** prot., datë 8.4.2019, i shtetasit A.K., i ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë (vendimi i ndërmjetëm në çështjen me nr. ***) dhe njëanshmëri të trupit gjykues Valbona Vata, H.M., dhe V.O.,; (14) denoncimi nr. *** prot., datë 8.7.2019, të shtetasit G.Y., i cili e akuzon subjektin e rivlerësimit për shkelje të etikës profesionale dhe zvarritje të procesit gjyqësor; (15) denoncim nr. *** prot, datë 26.9.2019, i shtetases M.K., e cila ankohet për 11 subjekte rivlerësimi lidhur me aftësitë profesionale të tyre dhe dhënien e vendimeve të padrejta; (16) denoncim nr. *** prot, datë 9.10.2019, dhe nr. *** , datë 21.2.2020, të shtetasit Gj.P., i cili ankohet për dhënien e dy vendimeve të padrejta nga trupi gjykues i përbërë nga subjekti i rivlerësimit Valbona Vata, L.D., dhe M.,; (17) denoncimi nr. *** prot., datë 21.10.2019, i paraqitur nga shtetasi M.Gj., i cili ankohet për 13 subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe Valbona Vata, duke i akuzuar për korrupsion, falsifikim të dokumenteve dhe dhënie të vendimeve të padrejta. Denoncuesi nuk ka paraqitur dokumente provuese; (18) denoncimi nr. *** prot., datë 17.2.2019, i paraqitur nga shtetasi A.K., i cili ankohet se trupi gjykues i përbërë nga Valbona Vata, H.M., dhe M.R., ka dhënë një vendim të padrejtë;

(19) denoncimi nr. *** prot., datë 24.3.2020, i paraqitur nga shtetasja K.V., e cila ankohet se subjekti Valbona Vata, H.M., dhe M.R., ka dhënë një vendim të padrejtë.

9.2 Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalës e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Si konkluzion, Komisioni në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, është “e aftë” pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtata e palëve dhe është efiçente në masë të pranueshme.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Valbona Vata, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, dhe referuar gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, pikës 1 të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Valbona Vata, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.12.2020

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Xhensila PINE
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj